



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.55/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Qëndrim Kryeziu kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2026, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.55/2026, e datës 29.06.2026, e parashtruar nga Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datën 29.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën, ZP.Anr.55/2026, të parashtruar nga Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se si kandidat për deputet ka qenë në pozitë të pabarabartë në procesin ankimor kundër KQZ, sepse KQZ ka pasur raportin e detajuar të rinumërimit dhe të gjitha të dhënat mbi gabimet e evidentuara dhe se nuk ka pasur qasje në këtë raport për të ditur me saktësi se në cilat QKN ka pasur gabime në numërimin fillestar. Tutje në ankesë pretendohet se rezultatet e rinumërimit nuk konfirmuan saktësinë e numërimit fillestar, por provuan ekzistencën e gabimeve reale dhe të përhapura, ku sipas të dhënave të krahasimit pas rinumërimit, nga 110 kandidatët e PDK-së, te 90 kandidatë ka pasur ndryshim të votave. Kjo do të thotë se ndryshime janë konstatuar te 81.82% e kandidatëve të PDK- së (90/110), dhe se ky fakt është qendror, pasi kur ndryshimet nuk shfaqen te një kandidat i vetëm, por te 90 kandidatë nga 110, atëherë nuk kemi të bëjmë me pakënaqësi individuale të ankuesit, por me tregues të qartë se saktësia e numërimit fillestar të votave preferenciale të PDK-së nuk është verifikuar në mënyrë të mjaftueshme. Po ashtu në ankesë theksohet se nga të dhënat zyrtare të KQZ-së rezulton se nga gjithsej 147,594 vota të

Partisë Demokratike të Kosovës të numëruara në QKN, janë rinumëruar vetëm 5,201 vota, që përfaqësojnë vetëm 3.52% të të gjitha votave të kandidatëve të këtij subjekti politik, Për pasojë, 96.48% e votave të kandidatëve të PDK-së nuk janë verifikuar përmes procesit të rinumërimit. Në total, vetëm në 5,201 vota të rinumëruara janë konstatuar 221 ndryshime absolute të votave ndërmjet kandidatëve, çka do të thotë se dhjetëra vota janë atribuar gabimisht kandidatëve të ndryshëm gjatë procesit fillestar të numërimit. Konkretisht, ankuesi thekson se pas procesit të rinumërimit, i janë shtuar 589 vota, që përfaqëson rreth 11.3% të totalit të votave të rinumëruara ($589/5,201 \times 100 = 11.32\%$). Ky ndryshim i konsiderueshëm ngre dyshime serioze mbi saktësinë e rezultateve. Tutje në ankese pretendohet se nga gjithsej 2,498 vendvotime, janë rinumëruar vetëm 185 vendvotime, që përbëjnë 7.41 % të vendvotimeve. Rrjedhimisht, 2,313 vendvotime, ose 92.59% e vendvotimeve, kanë mbetur pa u rinumëruar, ku në aspektin e votave të PDK-së, nga gjithsej 147,594 vota të PDK-së, janë verifikuar përmes rinumërimit vetëm 5,201 vota, që përbëjnë 3.52% të votave të PDK-së. Kjo do të thotë se 142,393 vota të PDK-së, ose 96.48%, nuk janë verifikuar përmes rinumërimit. Poashtu në ankese theksohet se mesatarisht, duke marrë parasysh pjesën e vendvotimeve të pa rinumëruara 92.59% dhe pjesën e votave të PDK-së të pa rinumëruara 96.48%, rreth 94.54% e masës relevante zgjedhore të PDK-së ka mbetur pa verifikim të dytë, për më tepër, një dallim kaq i madh 589 vota më shumë për ankuesin nga kaq pak vota të rinumëruara 5,201 vota kërkon numërimin një për një të të gjitha votave të kandidatëve të PDK-së.

Sipas rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ, ankuesi Qëndrim Kryeziu thekson se ka marrë një numër të caktuar votash që e renditin jashtë kandidatëve që kanë fituar mandatin. Megjithatë, duke pasur parasysh se vetëm në rinumërimin e 5,201 votave ankuesit i janë shtuar 589 vota (11.3%), ekziston një dyshim objektiv dhe serioz se numërimi i votave të ankuesit në pjesën tjetër të votave (96.48%) mund të ketë gabime të ngjashme,

Pala ankuese kërkon aprovimin e ankeses si të bazuar si dhe të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të zhvillojë rinumërimin e plotë të të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të Partisë Demokratike të Kosovës për kandidatët për deputet nga të gjitha vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërimin e urdhëruar me Vendimin nr. 01/1300-2026.

KQZ ka sqaruar se ankuesi kundërshton vendimin e KQZ-së të miratuar në mbledhjen nr. 69/2026, të datës 27.06.2026, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07.06.2026. Me Vendimin e KQZ-së Nr.01/1300-2026, të datës 17.06.2026, është urdhëruar rinumërimi i plotë i 185 vendvotimeve të rregullta, që përbëjnë 7.41% të gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta. Procesi i rinumërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve ka filluar më 18.06.2026, në orën 08:00, dhe është përmbyllur më 19.06.2026, në orën 12:00. Sipas të dhënave zyrtare të krahasimit ndërmjet rezultateve të administruara në QKN dhe rezultateve pas rinumërimit në QNR, votat e ankuesit kanë ndryshuar vetëm në dy vendvotime. Në total, ankuesi ka dy (2) vota më pak pas rinumërimit. Për rrjedhojë pretendimi se ankuesit i janë shtuar 589 vota nuk përputhet me të dhënat zyrtare të publikuara nga KQZ-ja. Këto të dhëna janë publikuar në mënyrë progresive për secilin vendvotim, kategori dhe komunë, si dhe në formë të përmbledhur, duke qenë të qasshme dhe lehtësisht të verifikueshme për ankuesin

dhe publikun. Prandaj, pretendimi për shtimin e 589 votave është në mënyrë absolute i pasaktë dhe i pambështetur në të dhënat zyrtare.

Raporti nga rinumërimi, i bashkangjitur kësaj përgjigjeje, tregon se ndryshimet në votat e kandidatëve kanë qenë në të dy drejtimet, me vota të shtuara dhe të zbritura. Shumica e dallimeve, përkatësisht rreth 92%, kanë qenë vetëm nga një votë për kandidat në një vendvotim. Në këto rrethana, ndryshimet e evidentuara paraqiten si të kufizuara dhe të izoluara, të lidhura kryesisht me rivlerësimin e fletëvotimeve dhe me gabime njerëzore gjatë numërimit fillestar, pa krijuar bazë të mjaftueshme për të nxjerrë përfundim për një model të përgjithshëm ose sistematik të pasaktësive në vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërim.

Megjithatë, kjo dispozitë nuk krijon një afat të ri për kontestimin e administrimit të numërimit në QKN ose QNR dhe as nuk mund të përdoret për rihapjen e pretendimeve për rinumërim, sipas nenit 105 të Ligjit nr. 08/L-228.

Në rastin konkret, ankuesi nuk pretendon ndonjë gabim konkret në përllogaritjen, tabulimin apo ndarjen e mandateve që rrjedh nga vendimi për shpalljen e rezultateve përfundimtare. Përkundrazi, ankesa përsërit kërkesën për rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve të PDK-së, duke u mbështetur në ndryshimet e evidentuara gjatë rinumërimit të 185 vendvotimeve. Për rrjedhojë, pavarësisht se ankesa është paraqitur formalisht kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare, përmbajtja e saj materiale lidhet me procesin e numërimit dhe rinumërimit të votave, për të cilin zbatohet afati i përcaktuar me nenin 105 të Ligjit nr. 08/L-228. Fakti se ankuesi e ka paraqitur ankesën pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nuk e ndryshon natyrën juridike të pretendimeve të tij dhe nuk e bën të aplikueshëm afatin për kontestimin e administrimit të numërimit në QKN ose QNR.

Në procedurën e mëparshme janë shqyrtuar në mënyrë të plotë pretendimet e ankuesit lidhur me rinumërimin e 185 vendvotimeve, ndryshimet e evidentuara në votat preferenciale të kandidatëve, pretendimi për shtimin e 589 votave për ankuesin, përqindja e votave të PDK së të përfshira në rinumërim, si dhe kërkesa për rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve të PDK-së.

Gjykata Supreme ka konstatuar se votat e ankuesit kanë ndryshuar vetëm në dy vendvotime dhe se, në total, ai ka dy (2) vota më pak pas rinumërimit, Prandaj, pretendimi për shtimin e 589 votave nuk përputhet me të dhënat zyrtare të krahasimit ndërmjet QKN-së dhe QNR-së. Prandaj, ankesa aktuale paraqet përsëritje të së njëjtës çështje faktike dhe juridike, me kërkesë thelbësisht të njëjtë për rinumërim të plotë të votave preferenciale të kandidatëve të PDK-së,

Referimi në deklaratën e Kryesuesit të KQZ-së nuk paraqet fakt të ri, pasi të dhënat nga rinumërimi dhe raporti përkatës kanë qenë pjesë e procedurës së mëparshme ankimore dhe janë shqyrtuar nga PZAP-ja dhe Gjykata Supreme,

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar

Paneli fillimisht konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e lejuar dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit të parapare ligjor, pasi që rezultati përfundimtar nga KQZ

është shpallur me datë 27.06.2026 në ora 12 kështu që ankesa është paraqitur me datë 29.06.2026.

Paneli në bazë të nenit 106 paragrafi 3 të LZP i vlerësoi pretendimet e ankuesit të paraqitura pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ, me të cilat kërkohet rinumërimi i plotë i votave preferenciale të kandidatëve të subjektit politik PDK, duke u mbështetur në ndryshimet e evidentuara gjatë procesit të rinumërimit të zhvilluar para shpalljes së rezultateve.

Paneli vlerëson se procedura e ankesave pas shpalljes së rezultatit përfundimtar ka për qëllim shqyrtimin e pretendimeve të mbështetura në prova konkrete që mund të vënë në dyshim ligjshmërinë ose saktësinë e rezultatit të shpallur, e jo rivlerësimin e çështjeve që tashmë kanë qenë objekt shqyrtimi gjatë fazave paraprake të administrimit dhe verifikimit të procesit zgjedhor.

Në këtë drejtim, Paneli konstatoi se ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij është bazuar në të njëjtat të dhëna dhe rezultate të rinumërimit që kanë qenë të njohura dhe të disponueshme edhe më herët gjatë procesit zgjedhor dhe që kanë qenë objekt vlerësimi nga organet kompetente. Ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re, konkrete dhe të individualizuar, e cila do të dëshmonte ekzistimin e parregullsive shtesë apo të një natyre të tillë që do të justifikonte ndërhyrjen në rezultatin përfundimtar të shpallur.

Paneli shqyrtoi pretendimin ankimor përkitazi se gjatë rinumërimit janë evidentuar ndryshime në numrin e votave të kandidatëve dhe se ankuesit i janë shtuar 589 vota dhe gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar dhe i pa mbështetur në prova, madje nga rezultatet e publikuara nga KQZ del se nuk rezulton një pretendim i tillë ankimore, por kandidati në fjalë ka rezultuar se ka 2 vota më pak pas rinumërimit dhe jo 589 vota më shumë.

Për rrjedhojë, Paneli vlerëson se pretendimet e ankuesit mbeten të mbështetura në të njëjtat prova dhe në përfundime statistikore të nxjerra nga rezultatet e rinumërimit, pa u shoqëruar me prova të reja që do të krijonin bazë të mjaftueshme juridike për të vënë në dyshim rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ apo për të urdhëruar rinumërimin e plotë të votave.

Paneli gjen se nga raporti i KQZ-së rezulton se krahasimi i votave të kandidatëve pas rinumërimit, rezulton se shumica e dallimeve janë minimale, pra vetëm nga një votë për kandidat në një vendvotim janë 92 % e dallimeve. Janë evidentuar 1,342 raste me rritje një votë dhe 1,023 raste me zbritje një votë. Dallimet më të mëdha janë më të rralla: 118 raste me rritje dy vota, 16 raste me tri vota dhe vetëm 2 raste me katër vota me shumë. Ndërsa, janë evidentuar 77 raste me zbritje dy vota, 4 raste me tri vota dhe 2 raste me katër vota. Bazuar në natyrën dhe përmasën e këtyre dallimeve, mund të vlerësohet se ato lidhen kryesisht me ri kategorizimin e fletëvotimeve gjatë rinumërimit, si dhe me gabime njerëzore gjatë numërimit në QKN. Dallimet janë të izoluara dhe të kufizuara në numër, me ndryshim maksimal katër votave për një kandidat në një vendvotim. Prandaj nga kjo rezulton se edhe nga ky raport i fundit ka dalë që ankuesi ka më pak 2 vota, jo siç ka pretenduar se i ka 589 vota në ankesën e parashtruar.

Sa i përket pretendimit se gjatë mbledhjes së KQZ-së janë pranuar publikisht gabime të evidentuara gjatë rinumërimit, Paneli vlerëson se vetë konstatimi i ekzistimit të gabimeve të

karakterit njerëzor apo teknik gjatë procesit zgjedhor nuk përbën, në vetvete, bazë të mjaftueshme juridike për të urdhëruar rinumërim të përgjithshëm, pa u dëshmuar se natyra, shtrirja dhe efekti i këtyre gabimeve kanë cenuar në mënyrë konkrete saktësinë e rezultatit përfundimtar.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara Paneli ka vlerësuar se ankesa e paraqitur nga kandidati për deputet të Kuvendit Kosovës Qëndrim Kryeziu, është e pabazuar, pasi që pretendimet e paraqitura në ankesë mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten në prova materiale që do të mundësonin konstatimin e një shkeljeje zgjedhore. Vetë pretendimi për manipulim apo tjetërsim të vullnetit të votuesve nuk mund të merret si bazë për aprovimin e ankesës pa prova konkrete dhe të verifikueshme. Për rrjedhojë, në mungesë të provave konkrete, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar në nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, si dhe nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.55/2026 më datën 01.07.2026

Kryesues i Panelit,
Kujtim Pasuli



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA 07-07-2026



AA.nr.33/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar, Qerim Ademaj dhe Faton Ademi, anëtarë, lidhur me ankesën e kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të refuzimit të ankesës lidhur me rinumërimin e plotë të të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të PDK-së, për kandidatët për deputet, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.55/2026, të datës 01.07.2026, në seancën e mbajtur me datë, 06.07.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, (PZAP), ZP.Anr.55/2026, të datës 01.07.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ZP.Anr.55/2026, të datës 01.07.2026, është vendosur: *"Refuzohet e pabazuar ankesa ZP.Anr.55/2026, e datës 29.06.2026, e parashtruar nga Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shpalljen e rezultateve përfundimtare, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026".*

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën pretendon se vendimi i PZAP-së është i gabuar dhe si i tillë duhet anuluar, sepse ka trajtuar ankesën si përsëritje të çështjes tashmë të gjykuar, ndërsa ankesa tani ngre pyetje thelbësisht më të gjerë lidhur me atë se, a e bënë fakti që 90 nga 110 kandidatë të PDK-së (81.82%) kanë rezultuar me ndryshim dhe që vetëm 3.52% e votave të PDK-së janë verifikuar, si të pa besueshëm rezultatin përfundimtare për të gjithë listën e PDK-së, pavarësisht se cili kandidat konkret përfitoj apo humbi vota në mostër. Këtë çështje nuk e ka trajtuar PZAP.



Sipas kandidatit, vetë raporti i KQZ-së, tani i disponueshëm, konfirmon shkallën reale të gabimeve dhe e hedhë poshtë cilësimin e PZAP-it si gabime të izoluar, mirëpo këto nuk mund të paraqiten si gabime të izoluar në kuptim statistikor, përkundrazi raporti përbën provë të një defekti sistematik e të përsëritur në metodologjinë e numërimit fillestar në QKN, në kundërshtim me parimin e saktësisë të nenit 101 par. 1 të Ligjit Nr. 08/L-228.

Në pretendimet tjera në ankesë, kandidati thekson se pala kundërshtare ka cenuar parimin e barazisë së armëve, ngase raportin në fjalë e ka pasur që në kohën e hartimit, ndërsa ankuesi e ka marrë tani, kur parashtron ankesë ndaj vendimit të PZAP-it. Pala kundërshtare po ashtu, nuk ka dhënë arsytim mbi nenin 101 dhe nenin 102 paragraf 4 të Ligjit nr. 08/L-228, meqë nga ky nen kërkohet që numërimi të udhëhiqet nga saktësia dhe transparenca, andaj në këtë mënyrë është shkelur nenin 31 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën për gjykim të drejtë dhe të pa anshëm.

Si përfundim, kandidati thekson se PZAP, ka aplikuar standard të gabuar provues, duke mos paraqitur asnjë provë të re konkrete mbi bazën e refuzimit të ankesës, kështu duke u shkelur neni 106 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 08/L-228. Standardi i GJEDNJ-së, në çështjen Mugesmango kundër Belgjikës nr. 310/15, dhoma e madhe ka vendosur se një ankesë zgjedhore konsiderohet serioze dhe e argumentueshme kur nuk mund të përjashtohet mundësia që parregullsitë e pretenduara të kenë ndikuar në rezultat, pa qenë e nevojshme që ankuesi të provoj ndikimin e saktë. Ndërsa në këtë rast kemi një mos – transparencë të vazhdueshme të KQZ-së, ngase mos publikimi i raportit, ka vënë ankuesin dhe publikun në pamundësi për të vlerësuar plotësisht shtrirjen e gabimeve përpara certifikimit final, kjo në kundërshtim me nenin 101 të cekur më lartë dhe barazinë e armëve në procedurë.

Ankuesi, po ashtu së bashku me ankesën ka bashkëngjitur marzhën e gabimit, rëndësinë statistikore dhe ndikimin në rezultatin përfundimtar, analizën e dokumenteve dhe projeksionin e gabimit, duke i propozuar Gjykatës Supreme, që të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj vendimin e PZAP-së, ZP.Anr.55/2026, të datës 01.07.2026, të urdhëroj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të zhvilloj rinumërim të plotë të të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të Partisë Demokratike të Kosovës për kandidatët për deputet, që nuk janë përfshirë në rinumërimin e urdhëruar me Vendimin nr. 01/1300-2026, të pezullojë certifikimin përfundimtar të rezultatit të zgjedhjeve të mbajtura me 07.07.2026, deri në përfundim të këtij ri numërimi të plotë si dhe të obligoj KQZ-në, që pas përfundimit të rinumërimit, të përpiloj rezultatet e reja përfundimtare dhe t'i publikoj ato në pajtim me ligjin.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.55/2026, i datës 01.07.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:



- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën, ZP.Anr.53/2026, të parashtruar nga Qëndrim Kryeziu, kandidat për deputet, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër rezultatit përfundimtar të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen 69/2026, të datës 27.06.2026, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07.06.2026. Objekti i ankesës kanë qenë pretendimet për procesin e rinumërimit nga KQZ-ja, ku faktet objektive të konstatuara nga vet administrata krijojnë dyshim objektiv dhe të arsyeshëm mbi saktësinë e rezultatit përfundimtar të votave të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike të Kosovës.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror Zgjedhor ka kërkuar refuzimin e ankesës si të pabazuar, me pretendim se KQZ ka sqaruar se procesi i verifikimit të votave të subjekteve politike dhe numërimit të votave preferenciale të kandidatëve është zhvilluar në të gjitha Qendrat Komunale të Numërimit në përputhje me legjislacionin zgjedhor dhe aktet nënligjore në fuqi. KQZ ka theksuar se rinumërimi i 185 vendvotimeve nuk është urdhëruar si rezultat i konstatimit të parregullsive sistematike në procesin e numërimit, por në bazë të mekanizmit kontrollues të paraparë me Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 02/2026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Zgjedhore Nr.14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se e njëjta është e pabazuar. Paneli fillimisht konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e lejuar dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit të parapare ligjor.

Sipas vendimit të panelit, në pjesën arsyetuese është konstatuar se ankuesi në mbështetje të pretendimeve të tij është bazuar në të njëjtat të dhëna dhe rezultate të rinumërimit që kanë qenë të njohura dhe të disponueshme edhe më herët gjatë procesit zgjedhor dhe që kanë qenë objekt vlerësimi nga organet kompetente. Ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë të re, konkrete dhe të individualizuar, e cila do të dëshmonte ekzistimin e parregullsive shtesë apo të një natyre të tillë që do të justifikonte ndërhyrjen në rezultatit përfundimtar të shpallur.

Paneli shqyrtoi pretendimin ankimor përkitazi se gjatë rinumërimit janë evidentuar ndryshime në numrin e votave të kandidatëve dhe se ankuesit i janë shtuar 589 vota dhe gjeti se një pretendim i tillë është i pa bazuar dhe i pa mbështetur në prova, madje nga rezultatet e publikuara nga KQZ del se nuk rezulton një pretendim i tillë ankimore, por kandidati në fjalë ka rezultuar se ka 2 vota më pak pas rinumërimit dhe jo 589 vota më shumë. Dallimet janë të izoluara dhe të kufizuara në numër, me ndryshim maksimal katër votave për një kandidat në një vendvotim. Prandaj nga kjo rezulton se edhe nga ky raport i fundit ka dal që ankuesi ka më pak 2 vota, jo siç ka pretenduar se i ka 589 vota në ankesën e parashtruar

Sa i përket pretendimit se gjatë mbledhjes së KQZ-së janë pranuar publikisht gabime të evidentuara gjatë rinumërimit, Paneli vlerëson se vetë konstatimi i ekzistimit të gabimeve të



karakterit njerëzor apo teknik gjatë procesit zgjedhor nuk përbën, në vetvete, bazë të mjaftueshme juridike për të urdhëruar rinumërim të përgjithshëm, pa u dëshmuar se natyra, shtrirja dhe efekti i këtyre gabimeve kanë cenuar në mënyrë konkrete saktësinë e rezultatit të përfundimtar. Bazuar në arsyet e sipërsëhënuara Paneli ka vlerësuar se ankesa e paraqitur nga kandidati për deputet të Kuvendit Kosovës Qëndrim Kryeziu, është e pabazuar, pasi që pretendimet paraqitura në ankesë mbeten në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten në prova materiale që do mundësonin konstatimin e një shkeljeje zgjedhore. Vetë pretendimi për manipulim apo tjetërsim të vullnetit të votuesve nuk mund të merret si bazë për aprovimin e ankesës pa prova konkrete dhe të verifikueshme.

- Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me refuzimin e ankesës së kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, lidhur me kërkesën për rinumërimin e plotë të votave preferenciale të kandidatëve për deputet të subjektit politik PDK në vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datë 7 Qershor 2026.

Sipas gjykatës, vendimi i PZAP është i drejtë, i ligjshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se drejtë është zbatuar Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se shkeljet e pretenduara në ankesë, nga kolegji i Gjykatës Supreme vlerësohen të pabazuara.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme në këtë çështje juridike janë pretendimet ankimore të kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së Vendimit të PZAP-së, ZP.Anr.55/2026, të datës 01.07.2026, me të cilin është refuzuar ankesa e kandidatit për deputet Qëndrim Kryeziu, e bazuar në pretendimin se PZAP ka trajtuar gabimisht çështjen si të gjykuar më parë dhe nuk ka shqyrtuar në themel pretendimet që lidhen me besueshmërinë e rezultatit zgjedhor, të mbështetura në raportin e verifikimit të KQZ-së.

Në lidhje me këtë, nga shkresat e lëndës, përkatësisht sipas raportit nga rinumërimi i 185 vendvotimeve të rregullta për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura me 07 qershor 2026, rezulton se, pas rinumërimit të 185 vendvotimeve janë evidentuar ndryshime në rezultatet e kandidatëve në të dy drejtimet, ku një numër kandidatësh minimalisht kanë fituar vota, ndërsa kandidatë të tjerë po ashtu në mënyrë minimale kanë humbur disa vota. Sipas vendimit të panelit dhe të dhënave zyrtare të krahasimit ndërmjet numërimit në QKN dhe rinumërimit në QNR, votat e kandidatit me numër 103, Qëndrim Kryeziu, kanë ndryshuar vetëm në dy vendvotime. Në total, kandidati ka dy (2) vota më pak pas rinumërimit dhe jo 589 vota më shumë, dhe se pretendimi për 589 vota nuk përputhet me të dhënat zyrtare të publikuara nga KQZ.



Nga ky raport, rezulton se krahasimi i votave të kandidatëve pas rinumërimit, konstaton se shumica e dallimeve janë minimale, pra vetëm me nga një votë për kandidat në një vendvotim janë 92 % e dallimeve. Janë evidentuar 1,342 raste me rritje për një votë dhe 1,023 raste me zbritje për një votë. Dallimet më të mëdha janë më të rralla: 118 raste me rritje për dy vota, 16 raste me tri vota dhe vetëm 2 raste me katër vota me shumë. Ndërsa, janë evidentuar 77 raste me zbritje dy vota, 4 raste me tri vota dhe 2 raste me katër vota.

Raporti thekson se bazuar në natyrën dhe përmasën e këtyre dallimeve, mund të vlerësohet se ato lidhen kryesisht me ri kategorizimin e fletëvotimeve gjatë rinumërimit, si dhe me gabime njerëzore gjatë numërimit në QKN.

Këto të dhëna janë publikuar në mënyrë progresive për secilin vendvotim, kategori dhe komunë, si dhe në formë të përmbledhur, duke qenë të qasshme dhe lehtësisht të verifikueshme për ankuesin dhe publikun, prandaj Gjykata Supreme, vlerëson se pretendimi për shtimin e 589 votave, nuk është i bazuar në prova konkrete apo të dhëna zyrtare. Sipas raportit nga rinumërimi, konstatohen se ndryshimet në votat e kandidatëve kanë qenë në të dy drejtimet, me vota të shtuara dhe të zbritura, ndërsa shumica e dallimeve, përkatësisht rreth 92% kanë qenë vetëm nga një votë për kandidat në një vendvotim.

Gjykata vlerëson se korrigjimet e evidentuara apo të pasqyruara në raport, nuk krijojnë një bazë objektive për të konkluduar se procesi i numërimit është karakterizuar nga parregullsia sistematike. Natyra dhe shpërndarja e këtyre korrigjimeve tregojnë se ato kanë qenë sporadike dhe nuk kanë arritur një intensitet të tillë që do të cenonte besueshmërinë e rezultatit përfundimtar apo integritetin e procesit të numërimit. Në këtë kuptim të dhënët e prezantuara nuk shërbejnë si bazë për aprovimin e ankesës dhe as për rinumërimin e plotë të të gjitha fletëvotimeve të vlefshme të Partisë Demokratike të Kosovës, për kandidatët për deputet, e për të gjitha vendvotimet që nuk janë përfshirë në rinumërimin e urdhëruar me Vendimin nr. 01/1300-2026.

Po ashtu, Gjykata Supreme gjen se ankuesi nuk ka paraqitur prova konkrete që do të mbështesnin pretendimet e tij për ekzistimin e parregullsive në procesin e numërimit përtej mostrës së verifikuar. Në veçanti, ai nuk ka paraqitur formularë të rezultateve, raporte të vëzhguesve, kundërshtime të evidentuara gjatë procesit të numërimit, apo ndonjë provë tjetër relevante nga e cila do të rezultonte se pasaktësitë e konstatuara në mostër/raport janë shfaqur edhe në vendvotime të tjera, ose se ato kanë qenë të natyrës sistematike. Për rrjedhojë, pretendimi se gabime të ngjashme mund të kenë ekzistuar edhe në vendvotimet e tjera mbetet në nivel hipotetik/supozime dhe nuk mbështetet në mënyrë të provuar siç kërkohet nga rregullat e procedurës zgjedhore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, procesi i rinumërimit të 185 vendvotimeve është urdhëruar nga KQZ-ja në kuadër të mekanizmit kontrollues të paraparë me ligj, me qëllim verifikimin e saktësisë së procesit të numërimit, dhe jo si pasojë e konstatimit të parregullsive sistematike në administrimin apo numërimin e votave.



Gjykata Supreme vlerëson se, ndonëse ankesa aktuale është paraqitur në një fazë tjetër të procesit zgjedhor, pas publikimit të raportit të KQZ-së dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare, pjesa më e madhe e pretendimeve të ngritura prej ankuesit janë të natyrës së njëjtë me ato që janë shqyrtuar më parë nga PZAP dhe Gjykata Supreme sipas aktgjykimit AA.nr.28/26 i datës 25.06.2026. Këto pretendime kanë të bëjnë me të njëjtat çështje juridike dhe faktike lidhur me kërkesën për rinumërim të fletëvotimeve të subjektit PDK. Për rrjedhojë, duke qenë se këto çështje janë trajtuar dhe arsyetuar në mënyrë të plotë në vendimet e mëparshme, Gjykata Supreme në këtë çështje lejueshmërinë e ankesës e ka vlerësuar në kuptimin se objekt shqyrtimi është vendimi i PZAP-së, i nxjerr pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, pavarësisht se në masë të konsiderueshme çështja në fjalë është konsumuar nga vendimet mëparshme të PZAP-së dhe Gjykatës Supreme.

Gjykata Supreme e vlerëson të pa themeltë pretendimin e paraqitur në ankesë lidhur me mangësitë e arsyetimit të vendimit të PZAP-së, për shkak se vendimi i PZAP-së, e ka trajtuar në substancë çështjen ankimore duke e pranuar si të provuar raportin e KQZ-së për rinumërimin e 185 vendvotimeve, mirëpo të gjeturat e raportit, respektivisht shkallës të gabimeve për kandidatët e subjektit në fjalë i ka vlerësuar se në kuptim të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, nuk ndikojnë në masën që të urdhërohet rinumërimi i tërësishëm. Në këtë kuptim vlerësohet se gjendja e konstatuar faktike e nxjerrë nga vlerësimi i mekanizimit kontrollues nuk ka krijuar bazë të provuar mbi marzhën e gabimeve se nga procesi i rinumërimit mund të nxirret rezultat tjetër. Në këtë proces vlerësohet po ashtu mundësia që kanë secili kandidat, subjekt për të evidentuar gabimet e kontestuar në të gjitha fazat e procesit të votimit dhe numërimit. Prandaj Gjykata Supreme ka gjetur se vendimi i PZAP nuk është i përfshirë në shkelje sa i përket strukturës dhe përmbajtjes së vendimit.

Për rrjedhojë Gjykata Supreme vlerëson se PZAP ka vendosur drejtë lidhur me refuzimin e ankesës së ankuesit, kandidatit për deputet të Kuvendit Kosovës Qëndrim Kryeziu, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe atë duke iu referuar dispozitës nga neni 118.1 të LZP-së, ku është përcaktuar se: *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe nenit 13 paragraf 4 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, ku është përcaktuar se: *"PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë"*. Po ashtu me nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se: *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*.

Mbi këtë bazë kjo gjykatë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e lartcekura se PZAP e ka refuzuar ankesën e ankuesit duke neglizhuar parimin e integritetit të procesit zgjedhor, me shkelje të ligjit material dhe të drejtave themelore të njeriut.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtresit të ankesës, prandaj, pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara.



Andaj, bazuar në arsyetimin e dhënë si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.33/2026, datë 06.07.2026

Kryetari i kolegjit,
Albert Zogaj



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik
